



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.219/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Hasan Shala dhe Adnan Konushevcu, anëtarë me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 2.500,00 (dymijë e pesqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 13.10.2017, me të cilën pretendon se në platformën KALLXO.com janë dërguar disa fotografi në të cilat shihen disa fëmijë të veshur me fanella të Partisë Demokratike të Kosovës, në sheshin e qytetit të Ferizajit, fare pran objektit të Komunës. Gjithashtu, ka theksuar se ky veprim bie ndesh me Rregullën Zgjedhore 13/2013, e cila përcakton se personat nën moshën 18 vjeçare nuk guxojnë të përfshihen në fushatë.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur 4 (katër) fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 14.10.2017, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka theksuar se pretendimet në ankesë janë krejtësisht të pabazuara dhe nuk përmbajnë shkelje të rregullave ligjore, nga fotot që janë prezantuar nuk mund të dëshkohet mosha e personave në to. Gjithashtu, ka theksuar se pretenduesi nuk ka dhënë asnjë argument që dëshmon zyrtarisht moshën e tyre. Prandaj, në rastin konkret ankuesi duhet të sjell fakte zyrtar me emra dhe mbiemra dhe moshën e tyre.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se subjekti politik PDK në Ferizaj, ka

përfshirë fëmijë në fushatë zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton se: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik PDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre kanë mohuar shkeljen e supozuar duke thënë se nga fotot e dërguara nga ana e parashtruesit të ankesës nuk mund të dëshmohej moshë personave në ato foto, mirëpo Paneli, nga fotografit e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se personat në ato foto janë nën moshën 18 vjeçare-fëmijë ku shihet qartë se janë të veshur me fanella të subjektit politik PDK, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton se: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Pretendimet në ankesë nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë.

Paneli po ashtu vlerësoj, dënimi me gjobë i shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr.219/2017 më datë 16.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejman



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.